

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS, QAFË THANË POGRADEC**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Qafë Thane, Pogradec, me objekt “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2012” dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 167, datë 27.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, u janë dërguar përkatësisht me shkresat nr. 713/7, datë 27.12.2013, z. Olsi Ekonomi, Kryetar i Degës së Doganës, Qafe Thanë dhe me nr. 713/8, datë 27.12.2013, znj. Elisa Spiropali, Drejtore e Përgjithshme e DPD, Tiranë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.** Dega e Doganës Qafë Thanë, të kërkojë nga Departamenti Operativ-Hetimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, hetimin e praktikave doganore DAV R-57, datë 06.01.2011, DAV R-6615, datë 02.06.2011, DAV R-2077, datë 03.04.2012 dhe DAV R-4049, datë 16.05.2012, të subjektit ■■■■, i cili ka importuar dhe deklaruar në Degën e Doganës Qafë Thanë artikuj të ndryshëm hidrosanitar, të cilët Dega e Doganës i ka trajtuar me MSABE, bazuar në deklaratat faturë nr. 0611087334, 0611087335, 0611087336, 0611087337 dhe 0611087338, datë 30.10.2010, nr. 0611095473, datë 27.05.2011 dhe nr. 0611117788, 0611117789, 0611117790, 0611117791, datë 30.03.2012, lëshuar nga i njëjti subjekt eksportues ■■■■, por autorizimi i subjektit eksportues, për praktikën e mësipërme është lëshuar në vitin 2008, dhe në bazë të Rregullores nr. 01/2009 “Mbi Statusin e Eksportuesit të Miratuar” të BE, ka afat përdorimi një vjeçar.

Nga mosveprimi i autoritetit doganor kompetent në shkëlqje të neneve 256.4, 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor, për katër praktikën e mësipërme ka rezultuar një efekt financiar i munguar në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit në vlerë **4,513,588 lekë**.

**Deri më 31.03.2014**

**2.** Dega e Doganës Qafë Thanë në bashkëpunim me Departamentin Teknik të DPD-së, të marrë të gjitha masat ligjore për mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv me të cilin operon subjekti ■■■■ mbasi shtyrjet e herë pas hershme të afateve të ri eksportimit të produkteve të gatshme, nuk kanë rezultuar të suksesshme. *(Më hollësisht është trajtuar në faqet 31-34 të RPA.)*

**Menjëherë**

**3.** Dega e Doganës Qafë Thanë, të marrë masat e nevojshme për funksionimin dhe rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellët me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Korçë, me Bankat e nivelit të dytë, me Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe veçanërisht me Departamentin Operativ Hetimor, pranë DPD dhe Zyrat e Përmbartimit Gjyqësor, për rikuperimin e borxhit doganor brenda afateve të përcaktuara me ligj.

**Menjëherë**

**4.** Dega e Doganës Qafë Thanë, të marrë masa konkrete, që të gjitha procesverbalet që përgatiten për shkëlqjet doganore të rezultuara, të jenë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH” neni 286.1, i cili duhet të përmbajë, vendin datën dhe kohën kur verifikohet shkëlqja, emrat e personave që nënshkruajnë raportin dhe autoritetin që

përfaqësojnë, të dhënat identifikuese të atij ose atyre që kanë kryer shkeljen doganore, llojin e shkeljes së kryer, mënyrën në të cilën është kryer shkelja.

**Menjëherë**

5. Dega e Doganës Qafë Thanë, të marrë masa që vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor kompetent të pajisen me një numër rendor të pa përsëritshëm gjatë një viti kalendarik dhe të jenë të protokolluar në mënyrë kronologjike.

**Menjëherë**

6. Nga Dega e Doganës Qafë Thanë të fillojnë procedurat për hipotekimin e Pikës Doganore Tushemisht me vlerë 89,073 mijë lekë të aplikojë për certifikatën përkatëse të pronësisë, konform legjislacionit përkatës.

**Menjëherë**

7. Dega e Doganës Qafë Thanë të marrë masa të plota ligjore, që sektori arkiv-protokollit të funksionojë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, nenet 17, 19 dhe 21, si dhe regjistrat e korrespondencës të ndërtohen sipas modeleve nr. 1 dhe 4.

**Menjëherë**

8. Të ndërmerren të gjitha hapat ligjorë, për të siguruar nga organet kompetente (komisioni ad-hoc) pranë Ministrisë së Financës çmimin referues për eksportin e artikullit hekur nikel, me qëllim krahasimin e çmimeve të deklaruara me çmimet referuese, për të mbajtur në kontroll të ardhurat që sigurohen nga taksa e rentës minerare.

**Menjëherë**

9. Dega e Doganës Qafë Thanë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 6,550,000 lekë, nëpërmjet nxjerrjes së vendimeve administrative për të gjitha subjektet rast pas rasti, bazuar në listën e paraqitur në faqet 16-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit (detyra nr. 24 e vendimit të KLSH), lënë në auditimin e mëparshëm nga KLSH, dërguar në Degën e Doganës Qafë Thanë me shkresën 494/6, datë 12.04.2011, që bën fjalë për importin e artikullit viça të gjallë, për 131 rastet e konstatuara sipas listës së paraqitur”, me detyrime doganore të papaguara në vlerë 6, 550,000 lekë.

**Deri më 31.03.2014**

10. Të merren masa, për zbatimin e vendimit nr. 254, datë 17.06.2010 të Gjykatës së Apelit Korçë, për detyrimet doganore dhe gjobat e vendosura ndaj subjektit ■■■ në vlerë 3, 889 mijë lekë.

**Deri më 31.03.2014**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nga Dega e Doganës Qafë Thanë, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqësorit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në **vlerë 31,478,785 lekë**, nga 37 subjekte, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur RPA dhe trajtuar nw faqet nr. 11-31 të RP të Auditimit; nga 33 subjekte, sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur RPA dhe trajtuar nw faqet nr. 11-31 të RP të Auditimit dhe nga 30 subjekte sipas aneksit nr. 3 bashkëlidhur RPA dhe trajtuar nw faqet nr. 37-53 të RP të Auditimit, për detyrime doganore të papaguara së bashku me sanksionet.

**Deri më, 31.03.2014**

## **C. MASA ADMINISTRATIVE**

1. Të merren të gjitha hapat ligjorë, për aplikimin e sanksioneve, për shkeljet administrative të kryera nga subjektet ■■■, trajtuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, faqe 58-61,

duke i gjobitur nga 50,000 deri në 200,000 lekë. Bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, të vendoset gjobë në shumën 200,000 lekë ndaj agjencisë doganore ■■■ dhe në shumën 50,000 lekë ndaj agjencisë doganore ■■■ (Më hollësisht janë trajtuar në faqet 11-31 të R P të Auditimit).

**Deri më 31.03.2014**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

1. Bazuar në VKM, nr. 205, datë 13.4.1999 të ndryshuar me vendimin nr. 686, datë 02.11.2005, për shkeljen e pikës nr. 16.1 germat “a” dhe “ë”, **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** të propozojë në Komitetin Disiplinor fillimin e procedurës për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

#### **“Largim nga puna”, pika 18.1.4 germa “e” për:**

1. ■■■ me detyrë doganier klasifikimi/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor, për 14 (katërbëdhjetë) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. ■■■, me detyrë përgjegjës turni, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.16 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor, për 11 (njëmbëdhjetë) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. ■■■, me detyrë doganier klasifikimi/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor, për 8 (tetë) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. ■■■, me detyrë ish-doganier klasifikimi/vlerë dhe përgjegjës turni, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenet 15.13 dhe 15.16 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor, për 7 (shtatë) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të R P Auditimit).

#### **“Ulje një shkallë në kategori dhe transferim nga pozicioni i punës 1 vit”, pika 18.1.4 germa “d” për :**

1. ■■■ me detyrë ish-doganier klasifikimi/vlerë dhe përgjegjës turni, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenet 15.13 dhe 15.16 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor, për 4 (katër) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. ■■■ me detyrë ish-përgjegjës turni, aktualisht në strukturat e antikontrabandës, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenet 15.13 dhe 15.16 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor, për 3 (tre) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. ■■■ me detyrë ish-doganier klasifikimi/vlerë dhe ish-përgjegjës turni, aktualisht përgjegjës turni në Degën e Doganës Korçë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenet 15.13 dhe 15.16 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në

zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor, për 3 (tre) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**“Gjobë nga 1 pagë mujore”, pika 18.1.4 germa “b” për :**

1. ■■■, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor, për 2(dy) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. ■■■, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 33-37 të Kodit Doganor, për 2 (dy) raste. (Trajtuar hollësisht në faqet 11-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Për punonjësit:

1. ■■■, me detyrë ish-Kryetar i Degës Doganore;
2. ■■■, me detyrë ish-jurist/specialist borxhi;
3. ■■■, me detyrë ish-doganier klasifikim/vlerë;
4. ■■■, me detyrë ish-jurist/specialist borxhi.

Nuk rekomandohet masë disiplinore, për arsye se ata i kanë shkëputur marrëdhëniet me sistemin doganor.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Livan Hoxha p/grupi, Agron Opari dhe Bashkim Shehu, më tej u shqyrtua nga K/audituesi z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.

**Mbi zbatimin e rekomandimeve:**

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave dhe Dega Doganore Qafë Thanë, Pogradec ende nuk kanë kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme të lëna nga auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**